



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA E TIRANËS  
QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_, \_\_\_\_, 2019

## Formular i njoftimit të fituesit

Data 15/01/2019

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “**M.C.Catering**” Sh.p.k dhe “**Regli**” Sh.p.k

Adresa : Rr. “Pjeter Budi”, Nd.29, H3, Ap.14, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë

Procedura e prokurimit: **Tender i Hapur**

Numri i Referencës për Procedurën: **Loti I** – “Blerje mish vici, mish pule dhe vezë” - **REF-92732-11-05-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti “**Blerje Ushqime**” për **QEZHEF** ndarë me lote – **Marreveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara – me nje Operator Ekonomik fitues per çdo lot - me afat të Marrëveshjes Kuadër 12 muaj : Loti I** – “Blerje mish vici, mish pule dhe vezë” - me fond limit 38 342 424 (tridhjetë e tetë milionë e treqind e dyzet e dy mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa T.V.SH. Fondi i mësipërm nuk i përfshin të gjitha detyrimet fiskale si dhe T.V.SH-në.

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 45, Datë 12 Nëntor 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “**Nelsa**” Sh.p.k

J71601012S

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 35 228 000 lekë pa T.V.SH.

2. Shoqëria “**Eglenti**” Sh.p.k

L28405201R

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 31 334 975 lekë pa T.V.SH.

3. Shoqëria “KAZAZI - MEAT” Sh.p.k

K73609801E

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 34 730 100 lekë pa T.V.SH.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M.C.Catering” Sh.p.k dhe “Regli” Sh.p.k

**M.C.Catering**

K72218022J

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

**Regli**

K48021206L

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 38 323 655 lekë pa T.V.SH.

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1) “Eglenti” Sh.p.k**

I.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.10, Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar:

I.1.1 Artikulli: Mish Viçi

OE nuk ka paraqitur certifikatë për cilësinë e ambalazhit.

I.1.2 Artikulli: Mish pule

OE nuk ka paraqitur certifikatë për cilësinë e ambalazhit.

I.1.3 Artikulli: Vezë pule

OE nuk ka paraqitur Raport Analizë Mikrobiologjike për vezën.

Oferta ekonomike 31 334 975 lekë pa T.V.SH

#### **2) “KAZAZI – MEAT” Sh.p.k**

2.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.7, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin që vërteton përmbushjen e plotë të këtij kriteri. Dokumentacioni i paraqitur në sistem nga OE është një kontratë qiraje e pasurisë së paluajtshme. Në këtë rast OE duhet të paraqiste dokumentacionin që vërteton posedimin e QKB licencë për “Mbarështimin dhe majmërimin për prodhimin e mishit të pulës”, si dhe dokumentacioni që vërteton kapacitetin e prodhimit jo më pak se 4000 kg mish pule të freskët në muaj. Licenca e paraqitur nga OE është e subjektit “Driza” shpk. Ky dokumentacion do të ishte i vlefshëm në rastin e kontratës të furnizimit me këtë subjekt.

2.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.8, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin që vërteton përmbushjen e plotë të këtij kriteri. Ka paraqitur kontratë furnizimi me AIBA

KOMPANI sha, por mungon dokumentacioni që vërteton posedimin e licencës për prodhimin e vezës së pulës nga AIBA KOMPANI sha.

Oferta ekonomike 34 730 100 lekë pa T.V.SH

### 3) “Nelsa” Sh.p.k

3.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.10, operatori nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikuajt e kërkuar:

#### 3.1.1 Artikulli: Mish viçi

Mishi është i ambalazhuar në letër tetrapack dhe jo në qeskë të pa-riciklueshme siç kërkohet në specifikimet teknike. OE nuk ka paraqitur Certifikatë Cilësie të ambalazhit. Mostra e mishit e paraqitur nuk e ka vulën e Veterinerit Zyrtar. OE nuk ka paraqitur Certifikatë Shëndetësore Veterinare, sikurse kërkohet në specifikimet teknike. OE ka paraqitur në Raport Analizë origjinale me Raport Prove nr. C7732/2018, datë 22.11.2018 të lëshuar nga ISUV, ku janë analizuar treguesit: lagështira 71.36% dhe pH 5.79, por këto nuk janë kërkesa të kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt.

#### 3.1.2 Artikulli: Mish pule

Mishi nuk është i ambalazhuar në qeskë polietileni, të pa-riciklueshme, sipas kërkesës në specifikimet teknike. OE ka nuk paraqitur Certifikatë Cilësie të ambalazhit. Mostra e mishit e paraqitur nuk e ka vulën e Veterinerit Zyrtar. OE nuk ka paraqitur Certifikatë Shëndetësore Veterinare, sikurse kërkohet në specifikimet teknike. OE ka paraqitur në Raport Analizë origjinale me Raport Prove nr. C7726/2018, datë 22.11.2018 të lëshuar nga ISUV, ku janë analizuar treguesit: lagështira 71.23% dhe pH 6.05, por këto nuk janë kërkesa të kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt.

#### 3.1.3 Artikulli: Vezë pule

Mostra e paraqitur: Vezë pule të markës tregëtare “Reas”, ndërkohë në sistem OE ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me OVVITAL shpk për furnizimin me vezë dhe jo me REA`S shpk. Në raport analizën e paraqitur në Komisionin për Verifikimin dhe Marrjen në dorëzim të mostrave mungon marka e artikullit “vezë”. Për këtë arsye, raport analiza nuk mund të lidhet me mostrën e paraqitur, për të përmbushur kriterin sipas specifikimeve teknike. Mostra e paraqitur nga OE nuk plotëson kriteret e kërkuara për ambalazhimin pasi në specifikimet teknike për ambalazhimin, kërkohet që vezët duhet të ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë.

Oferta ekonomike 35 228 000 pa T.V.SH

### **KVO vendosi të kualifikojë Bashkimin e operatorëve ekonomikë si më poshtë:**

1. “M.C.Catering” Sh.p.k dhe “Regli” Sh.p.k me ofertë ekonomike 38 323 655 lekë pa T.V.SH.

Përsa mësipër njoftimi i klasifikimit u publikua më datë 18.12.2018.

Në afatet ligjore të parashikuara, ka pasur ankesa në Autoritetin Kontraktor nga Operatorët Ekonomikë “Nelsa” Sh.p.k dhe “KAZAZI – MEAT” Sh.p.k.  
Ka mbaruar afati ligjor i ankesave pranë KPP-së.


\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “M.C.Catering” Sh.p.k. dhe “Regli” Sh.p.k, me adresë kryesore : Rr. “Pjeter Budi”, Nd.29, H3, Ap.14, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë, se oferta e paraqitur, prej 38 323 655 (tridhjetë e tetë milion e treqind e njëzetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH dhe 45 988 386 (dyzet e pesë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë me T.V.SH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të depozitoni pranë **Autoritetit Kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, me adresë Rr. “ Barrikadave ”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, kopjen e nënshkruar te formularit te kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi është bërë në datë 18.12.2018.



Titullari i Autoritetit Kontraktor

**Zhaneta BEQIRI**